



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health

30 Prill 2020

Nr. Xx/2020

Bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr. 05/L -031 - Për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 38 të Ligjit 04/L-190- Për Produkte dhe Pajisje medicinale, nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 02/2019 - Për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, Vendimin nr. protokollin 35/2019, datë 27.06.2019, me rastin e shqyrtimit të kërkesës me Nr. 6, të datës 28.03.2020, nga Kompania **Belupo d.d**, me seli në _____, me adresë: _____, me person përgjegjës **Adonis Sylka**, të ushtruar kundrejt vendimit të komisionit për çmime të publikuar më 23 Mars në webfaqen e MSH, Komisioni për çmime, në takimin e mbajtur me datë 30.04.2020, nxjerr këtë:

VENDIM

Nuk aprovohet kërkesa për rishqyrtim të çmimeve e parashtruar nga Kompania **Belupo d.d** me seli në _____, rruga _____.

Çmimet finale janë si vijon:

1. Afloderm, aclometasone, cream, 0.5mg/g: €2.55
2. Afloderm, aclometasone, ointment, 0.5mg/g: €2.55
3. Zaracet, tramadol+paracetamol, 37.5mg+325mg: €0.75
4. Pinox, lercanidipinum, film coated tablet, 10mg: €1.84

Arsyetimi

Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht komisioni për çmime bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve medicinale pas zhvillimit të procedurave të parapara me aplikacionet, dhe evalumin e tyre më datë 23 Mars 2020 ka publikuar vendimin për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale të cilat posedojnë autorizim për marketing pranë AKPPM. Bazur në paragrafin 1 të nenit 17 kundër vendimit të komisionit pala ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim në komisionin për çmime në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimeve.

Kompania **Belupo d.d**, me seli në _____, rruga _____, bazuar në paragrafin 1 të nenit 17 të UA 02/2019, brenda afatit ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim të çmimeve të produkteve medicinale si vijon

1. Afloderm, aclometasone, cream, 0.5mg/g, për të cilin ka aplikuar për çmimin €2.77
2. Afloderm, aclometasone, ointment, 0.5mg/g, për të cilin ka aplikuar për çmimin €2.77
3. Zaracet, tramadol+paracetamol, 37.5mg+325mg, për të cilin ka aplikuar për çmimin €1.74
4. Pinox, lercanidipinum, film coated tablet, 10mg, për të cilin ka aplikuar për çmimin €2.94

Komisioni duke u bazuar në dispozitat e udhëzimit administrativ përkatësisht në paragrafin 2 të nenit 17 të UA 02/2019 ka përcaktuar si vijon:





MAH: BELUPO PHARMACEUTICALS & COSMETICS-CROATIA

Emri i produktit	INN	Forma farmaceutike	Fortesia	Madhesia e paketimit	Cmimi i deklaruar	Cmimi në € në vendet referente/originës	Çmimi final në Euro	Komenti nga komisioni
AFLODERM® cream	alclometasone	CREAM	0.5mg/g	20g	2.77	MK-2.37, ME-2.57, HR-2.92, AL-2.34	2.55	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të çmimeve të vendeve referente.
AFLODERM® ointment	alclometasone	OINTMENT	0.5mg/g	20g	2.77	MK-2.37, ME-2.57, HR-2.92, AL-2.34	2.55	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të çmimeve të vendeve referente.
ZARACET	Tramadol+Paracetamol	FILM COATED TABLET	37.5mg +325mg	10 tab	1.74	MK-0.97, HR-0.52, AL-1,69	0.75	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të çmimeve të vendeve referente duke hequr çmimin e Shqipërisë si çmim i lartë.
PINOX	Lercanidipinum	FILM COATED TABLET	10mg	28 tab	2.94	MK-3.44, HR-1.84	1.84	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të çmimeve të vendeve referente duke hequr çmimin e Maqedonisë si çmim i lartë.

Nga sa u tha u vendos si në dispozit të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala ka të drejtë ankese 15 ditë kalendarike pas shpalljes së kësaj përgjigjeje në Bordin për Ankesa për çmime të produkteve medicinale në Ministrinë e Shëndetësisë.

Komisioni për çmime:

1. Naim Bardiqi MSH kryetar 
2. Selvete Shuleta AKPPM anëtare 
3. Etrit Tetova AKK anëtar _____
4. Amir Keka FSSH anëtar 
5. Shkumbin Jusufi OFK anëtar _____
6. Dardan Nallbani MTI anëtar _____
7. Blerta Kika MF anëtare 

Vendimi i dërgohet:

Palës,

Departamenti farmaceutik,

Arkivës.